



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-464/01-7589, dt. 18.02.2022

Në bazë të dispozitave të nenve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), të dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit nr.12-460-40369, të dates 23.09.2020 (Për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronave të paluajtshme- të njesive të ndërtesave-banesave), Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.12-464/01-51562, të dates 26.11.2021 (Për shpronësim e njësive të ndërtesave –Banesave,në ZK. Gllogoc), Kryetari i Komunës së Drenasit si organ shpronësues me datë 18 shkurt 2022, merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I

Miratohet shpronësimi për interes publik të njësive njësive të ndërtesave-banesave, të cilat ndodhen në zonën kadastrale në Gllogoc, në parcelen 743/29 e cila është prone e Komunës së Drenasit, të cilat preken nga realizimi i projektit ‘Rregullimi i Qendrës së qytetit në Drenas’, konform Planit zhvillimor Komunal 2020-2028, sipas tabelës të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interes publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

II

Pjesë integrale e këtij vendimi është Akti i Vlerësimit i punuar nga Zyra për vlerësimin e pronave të paluajtshme/Ministria e Financave dhe lista në formë tabelare e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

III

Brenda pesë (5) ditëve të punës pas mirimit të këtij Vendimi, organi shpronësues i dërgon Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në listen e paraqitur në formë tabelare e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi.

IV

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Vendimi Përfundimtar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.

V

Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Glllogoc, çdo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtëpërdrejtë në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

VI

Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në Gjykatën Kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë pesë (5) kopje të ankesës të cilat do të dorëzohen fizikisht në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues – Komuna e Drenasit, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse.

VII

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që brenda afatit prej dy (2) vite, që të paguaj plotësisht shumën e kompensimit sipas Aktit të Vlerësimit të përgatitur nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe titujve juridik të cilët i kanë paraqitur pronarët me rastin e vërtetimit të drejtës së Pronësisë mbi Njësitë Kadastrale.

VIII

Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrimin në librat kadastral në emër të titullarit të ri si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

IX

Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Iu dërgohet;

- Pronarëve ose Zotëruesve të Interesit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financave
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Arkivit të Komunës



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Tatimit në Pronë

Komuna: Drenas Zona Kadastrale: Drenas

Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese						Vlerësimi sipas DTP-së			
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ / m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit (€ / m ²)	Totali (€)
3	Leku Tahir (Ukë)	O-70315016-00743-1-25-1-1-0	banesë	33	33			385.00	12,705.00
4	Maxhuni Liridon (Halil) 1/2 Maxhuni Armend (Halil) 1/2	O-70315016-00743-1-26-2-1-0	banesë	33	33			385.00	12,705.00
5	Haliti Xhafer (Musli)	O-70315016-00743-1-26-3-1-0	banesë	33	33			350.00	11,550.00
6	Hisenaj Agim (Ujkan)	O-70315016-00743-1-27-1-1-0	banesë	33	33			385.00	12,705.00
7	Veliu Arbnora (Murat)	O-70315016-00743-1-27-2-1-0	banesë	32.8	32.8			315.00	10,332.00





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Tatimit në Pronë

Komuna: Drenas Zona Kadastrale: Drenas

Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese						Vlerësimi sipas DTP-së			
Nr.	Pronar	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ / m ²)	Vlera për dru pyjor dhe frutor (€)	Vlera e Investimit m ² / (€)	Totali (€)
1	Istogu Elver (Sheqir)	O-70315016-00743-1-22-2-1-0	banesë	30	30			385.00	11,550.00
2	Prokshi Nezir (Sherif)	O-70315016-00743-1-22-3-1-0	banesë	35	35			30.00	1,050.00
Total					65				11,550.00

12,600.00



Approvohet
Thaçi
19.01.2022